



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA ZYRA E  
AUDITORIT TË PERGJITHSHËM/KANCELARIJA GENERALNOG  
REVIZORA/OFFICE OF THE AUDITOR GENERAL**

**Nr. i dokumentit: 22.14.1-2009-08**

**RAPORTI FINAL I AUDITIMIT TË PASQYRAVE FINANCIARE TË  
KOMUNËS SË PRIZRENIT PËR FUND VITIN 31 DHJETOR 2009**

**Prishtinë, Qershor 2010**

## **Tabela e përmbajtjes**

- I. Përmbledhje e përgjithshme
- II. Hyrje
- III. Objektivi dhe Fushëveprimi i auditimit
- IV. Qasja e auditimit
- V. Opinioni i auditimit
- VI. Gjendja e rekomandimeve nga vitet e kaluara
- VII. Të gjeturat dhe rekomandimet kryesore të auditimit

### **Shtojcat:**

- I. Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit (ISSAI 400)
- II. Komentet e Komunës së Prizrenit dhe konkluzionet e ZAP-it

## Lista e shkurtesave

AK	Autoriteti Kontraktues
AP	Auditori i Përgjithshëm
APP	Agjensioni për Prokurim Publik
CHF	Cooperative Housing Foundation
DUKMM	Departamenti i Urbanizmit, Kadastrës dhe Mbrojtjes së Mjedis
DUPH	Departamenti i Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor
FNK	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
LMFPP	Ligji Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë
LPP	Ligji Për Prokurimin Publik në Kosovë
LIVTH	Llogaria e vetme e Thesarit
MTPT	Ministria e Transportit, Postës dhe Telekomunikacionit
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
NPK	Ndërmarrja Publike Komunale
OE	Operatori Ekonomik
PF	Pasqyrat Financiare
SIDA	Organizatë Suedeze
SIMFK	Sistemi Informativ i Menaxhimit Financiar të Kosovës
SNKSP	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
UA	Udhëzimi Administrativ
ZAP	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm

## I. Përmbledhje e Përgjithshme

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP), ka kryer auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Prizrenit (Komuna) për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2009.

Auditimi jonë është kryer, në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit të hartuara, nga INTOSAI dhe ka përfshirë testet dhe procedurat që ne menduam se ishin të nevojshme, për të dhënë një opinion lidhur me pasqyrat financiare.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare *prezantojnë pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare si dhe rezultatet e aktiviteteve operative për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2009, në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP) “Raportimi Financiar, në Bazë të Kontabilitetit të Parasë se Gatshme”. Ne dëshirojmë tu tërheqim vëmendjen në faktin se në Pasqyra Financiare nuk janë shpalosur informatat në vijim:

- Pagesat e bëra nga palët e treta dhe informatat shtesë për të pagueshmet, të arkëtueshmet dhe pasuritë tjera të përcaktuara si pasuri jo financiare; dhe
- Në shënimin 27 të pasqyrave financiare, Komuna nuk kishte shpalosur një regjistër gjithëpërfshirës mbi pasuritë jo financiare.

**(ISSAI 400: *Opinion i Pakualifikuar me theksim të çështjes*).**

Auditimi ynë i pasqyrave financiare, transaksioneve financiare dhe menaxhimit financiar ka identifikuar dobësi në të gjitha fushat kryesore, të cilat duhet të adresohen urgjentisht nga menaxhmenti në mënyrë që të përmirësohet efektiviteti dhe efikasiteti i organizatës.

Auditimi i kryer ka rezultuar me të gjeturat dhe rekomandimet si në vijim:

1. Kontrollat jo të duhura dhe të pamjaftueshme në lidhje me të hyrat vetjake të Komunës
2. Avanset për udhëtime zyrtare janë menaxhuar në mënyre joadekuate;
3. Mangësitë e vërejtura në lidhje me kontrollat e brendshme për sa i takon prokurimeve, janë jashtëzakonisht serioze dhe në mënyrë të theksuar e rrisin rrezikun e prokurimeve të Komunës ndaj mashtrimit, humbjes dhe keqpërdorimit;
4. Detyrimet e pa paguara në afatin e përcaktuar kohor në vlerë mbi 2,000,000 €;
5. Shuma prej 5,108 € e paguar në vitin 2009 ishte detyrim kontingjent;
6. Regjistri i pasurive fikse nuk ishte i kompletuar; dhe
7. Funkzioni i Auditimit të Brendshëm ka nevojë për forcim.

Dobësitë e identifikuar në kuadër të këtij raporti kemi arritur një konkluzion të përgjithshëm se nevojiten përpjekje të mëtutjeshme, përmirësimin e Menaxhimit Financiar dhe kontrollit brenda komunës së Prizrenit.

Një program revitalizues duhet të organizohet posaçërisht për të adresuar forcimin në:

- Raportimin e jashtëm;
- Raportimin e brendshëm;
- Delegim i qartë dhe transparent dhe ndarje e detyrave;
- Përcjellje menaxheriale; dhe
- Auditim të brendshëm funksional.

Menaxhmentit të Komunës i është dhënë mundësia për të dhënë komente mbi draftin e këtij raporti. Në këtë raport janë bërë më pas një numër ndryshimesh .

Çështjet e papërfunduar , për të cilat në si auditorë dhe entiteti i auditorë ende kemi pikëpamje te ndryshme , mund ti gjeni ne shtojcën 2.

Menaxhmenti është zotuar që do ti bëjnë të gjitha përpjekjet për ti adresuar të gjitha rekomandimet e dhëna.

## **II. Hyrje**

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është përgjegjëse për kryerjen e auditimeve vjetore të rregullsisë së Institucioneve Publike të Kosovës.

Është përgjegjësi e menaxhmentit të Komunës së Prizrenit të përgatisë pasqyrat financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin financiar në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme”, në përputhje me Udhëzimin Administrativ 20/2009, dhe ato ti prezantoj me kohë.

### **III. Objektivi dhe Fushëveprimi i auditimit**

Auditimi i Komunës së Prizrenit ka të bëjë me pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2009.

Auditimi i Rregullsisë është definuar si verifikim i kontabilitetit financiar, duke përfshirë ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e opinioneve:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin;

### **IV. Qasja e auditimit**

Qasja jonë e auditimit është zhvilluar gjatë këtij viti. Kemi adoptuar manualin e ri për auditimin tonë të rregullsisë që është më konform standardeve të auditimit të njohura ndërkombëtarisht. Ne kemi analizuar qasjen tonë të auditimit sipas katër fushave kryesore, si vijon:

- Të kuptuarit e Entitetit – të kuptojmë plotësisht entitetin, përfshirë këtu edhe kornizën e autoriteteve dhe të sistemeve kyçe, në mënyrë që të kuptojmë çështjet kyçe të cilat mund të kenë ndikim në pasqyrat financiare;
- Identifikimi i Rrezikut: duke kuptuar Entitetin dhe nga rezultatet e mëhershme të auditimit, ne identifikojmë rreziqet të cilat mund të shpijnë në keq deklarim material në pasqyra financiare ose mospërputhshmëri me ligjin;
- Kontrollat e Brendshme të Menaxhimit: aty ku identifikohen rreziqet, në kërkim të identifikojmë menaxhimin dhe kontrollat monitoruese të cilat mund të zvogëlojnë ato rreziqe; dhe
- Përdorimi i Procedurave Substanciale dhe Analitike – për të ofruar një siguri të auditimit me vëmendje të veçantë tek fushat ku dobësitë në kontrolle janë identifikuar.

Ne duhet kuptuar kontrollat e brendshme mjaftueshëm për të vlerësuar rrezikun e keq deklarimit material. Në përputhje me këtë kërkesë dhe punës sonë sipas kontrolleve të brendshme të

menaxhimit të theksuara më lart, në dokumentojmë kontrollet e menaxhimit dhe ato monitoruese që të na ndihmojnë në informimin e gjykimit tonë për rreziqet e keq deklarimit material.

Ne planifikojmë dhe kryejmë auditimin për të qenë në gjendje të ofrojmë siguri të arsyeshme. Ne aplikojmë materialitetin për të na ndihmuar në planifikimin e auditimit tonë dhe vlerësimin e të gjeturave tona të auditimit. Në terme të përgjithshme, ( siç specifikohet në standardet e auditimit) ne konsiderojmë që një çështje është materiale nëse mos shpalojta, keq deklarimi, përfshirja ose lënie jashtë e saj, me gjasë do të mund të ndërronte pikëpamjen e përgjithshme të dhënë nga pasqyrat financiare tek shfrytëzuesit.

- mund të trajtohen rekomandimet e mëparshme;
- të adresohen Pasqyrat Vjetore Financiare; dhe
- të adresohen çështjet e menaxhimit financiar gjatë vitit aktual.

Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësive tona, ne kemi ndërmarrë aktivitetet si në vijim :

1. Kemi rishikuar pasqyrat financiare të Komunës në raport me buxhetin e miratuar për vitin 2009.
2. Kemi përcaktuar nëse pasqyrat financiare të Komunës janë përgatitur në pajtim me SNKSP “Raportimi Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme”;
3. Kemi përcaktuar nivelet e materialitetit të 1% si prag për lehtësimin e përcaktimit të llojit të opinionit që duhet dhënë mbi pasqyrat financiare;
4. Kemi zbatuar një kombinim të mostrimit sipas gjykimit dhe sipas rastit në përzgjedhjen e transaksioneve për testim;
5. Kemi kryer teste substanciale gjithëpërfshirëse mbi transaksionet financiare;
6. Jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve financiare;
7. Kemi vlerësuar cilësinë e punës së Njësisë së Auditimit të Brendshëm në Komunë.

Në këtë raport ne përmbledhim auditimin e këtij viti dhe japim një opinion formal mbi Pasqyrat Vjetore Financiare 2009.

Lidhur me opinionin tonë të auditimit për pasqyrat financiare të Komunës, standardet ndërkombëtare përcaktojnë kriteret specifike të cilat rregullojnë llojin e opinionit që mund të jepet. Këto janë të përcaktuara më gjerësisht në Shtojcën 1.

## V. Opinion i auditimit

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare *prezantojnë pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare si dhe rezultatet e aktiviteteve operative për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2009, në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP) “Raportimi Financiar, në Bazë të Kontabilitetit të Parasë se Gatshme”. Ne dëshirojmë tu tërheqim vëmendjen në faktin se në Pasqyra Financiare nuk janë shpalosur informatat në vijim:

- Pagesat e bëra nga palët e treta dhe informatat shtesë për të pagueshmet, të arkëtueshmet dhe pasuritë tjera të përcaktuara si pasuri jo financiare; dhe
- Në shënimin 27 të pasqyrave financiare, Komuna nuk kishte shpalosur një regjistër gjithëpërfshirës mbi pasuritë jo financiare.

**(ISSAI 400: *Opinion i Pakualifikuar me theksim të çështjes*).**

## VI. Gjendja e rekomandimeve të viteve të kaluara

Raporti ynë i auditimit të Pasqyrave Financiare për vitin 2008 kishte dhënë 7 rekomandime kryesore. Auditimi ynë i tanishëm ka vërejtur se Komuna e Prizrenit ka implementuar pjesërisht dy prej tyre, ndërsa 5 të tjera kanë mbetur ende të pa adresuara.

Fushat më të rëndësishme të cilat duhet ende të adresohen janë:

- (a) Rekomandimet për harmonizimet mujore në mes të të dhënave të drejtorive, dhe drejtorisë të financave.
- (b) Rekomandimet për zhvillimin e procedurave të prokurimit në përputhje me ligjet e aplikueshme;
- (c) Menaxhimi i avanseve për udhëtime zyrtare dhe aplikimin e rregullave financiare;
- (d) Regjistrimi i plotë i detyrimeve financiare dhe raportimi i tyre me kohë në pasqyrat financiare; dhe
- (e) Rekomandimi për regjistrimin e pasurisë fikse në harmoni me UA nr. 21/2009.

Mospërfillja dhe implementimi i plotë i rekomandimeve tona kanë rezultuar me problemet e njëjta si në vitet e mëparshme. Shprehim shqetësimin tonë, për të gjitha rekomandimet e pa implementuara.



## VII. Të gjeturat dhe rekomandimet kryesore të auditimit

### VII. 1 Rezultati Financiar në krahasim me Buxhetin e Aprovuar

Analiza e Rezultatit në Pasqyrat Financiare kundrejt Buxhetit të Aprovuar tregon

**Tabela 1: Buxheti dhe Shpenzimet**

	Buxheti 2009			Pagesat	Pagesat	Pagesat
	Fillestar	Rishikuar	Final	2009	2008	2007
Granti qeveritar dhe Ndihma	18,534,000	18,875,000	19,348,000	19,133,000	13,801,000	12,144,000
Te Hyrat Vetjake	3,948,000	3,948,000	5,456,000	4,667,000	4,393,000	4,457,000
<b>Totali</b>	<b>22,482,000</b>	<b>22,823,000</b>	<b>24,804,000</b>	<b>23,800,000</b>	<b>18,194,000</b>	<b>16,601,000</b>
Paga dhe Mëditje	9,627,000	10,249,000	10,284,000	10,112,000	8,671,000	7,733,000
Mallra dhe Shërbime	2,074,000	2,009,000	2,589,000	2,145,000	2,369,000	2,056,000
Shërbimet Komunale	612,000	546,000	598,000	543,000	657,000	993,000
Subvencionet dhe Transferet	316,000	316,000	371,000	347,000	314,000	293,000
Investime Kapitale	9,853,000	9,703,000	10,962,000	10,653,000	6,183,000	5,526,000
<b>Totali</b>	<b>22,482,000</b>	<b>22,814,000</b>	<b>24,804,000</b>	<b>23,800,000</b>	<b>18,194,000</b>	<b>16,601,000</b>

Buxheti Komunal përbehet nga granti qeveritar, të hyrat vetjake, donacionet dhe të hyrat tjera. Gjatë vitit 2009 komuna ka shpenzuar 23,799,656 € apo 95% nga buxheti i aprovuar. Në bazë të tabelës së mësipërme rezulton se pjesa më e madhe e buxhetit është realizuar për investime kapitale dhe paga e mëditje . Krahasuar me vitin 2008 shpenzimet e përgjithshme të Komunës janë rritur për 30.8%.

Sipas analizave dhe procedurave analitike, burim i shpenzimeve për vitin 2009 ishin: granti qeveritar në shumë prej 18,744,727 €, të hyrat vetjake 4,667,359 €, donacionet e brendshme dhe të jashtme në shumë prej 387,570 €.

Buxheti i pa shpenzuar në fund të vitit 2009 ishte 1,004,343 €. Prej kësaj, mjetet e pa shpenzuara ishin: nga buxheti 130,273 €, nga të hyrat vetjake 788,640 € dhe nga donacionet 85,430 €.

## **Konkluzion**

Sipas vlerësimit tonë, Komuna kishte shpenzuar buxhetin e përgjithshëm për vitin 2009 sipas parashikimeve dhe limiteve të përcaktuara nga Kuvendi i Kosovës. Shkalla e ekzekutimit buxhetor ishte 95%. Mirëpo, rreth 2 milion obligime të papaguara, paraqesin ngarkesë dhe çrregullim për buxhetin e vitit 2010.

## **VII.2 Pasqyrat Financiare**

### **2.1 Cilësia e informatave**

Përkundër shfrytëzimit të një programi të kontabilitetit të brendshëm për regjistrimin e të hyrave dhe shpenzimeve, si burim kryesor të informatave në të cilën bazohet Komuna për përgatitjen e pasqyrave financiare është Free Balance.

Edhe pse Zyrta Kryesor Financiar ka nënshkruar deklaratën për prezantimin e pasqyrave financiare, Komuna nuk ka arritur të përgatis një draft të pasqyrave financiare në Gjuhën Angleze dhe në Gjuhën Serbe përpara fillimit të auditimit dhe gjatë periudhës sonë të auditimit.

Për me tepër, pasaktësitë në vijim nuk janë korrigjuar nga ana e Menaxhmentit dhe për këtë ne po u raportojmë ato në pajtim me ISSAI 1260:

- Pasqyra e pranimit dhe pagesave në para të gatshme nuk është bërë sipas Udhëzimit Administrativ 20/2009. Sipas nenit 9 pika 3 të këtij Udhëzimi administrativ kërkohet që shuma e paraqitur si pranim është shuma aktuale e pagesave përmes LIVTh dhe paraqet burimin e fondeve të shpenzuara;
- Në shënimin 27 të pasqyrave financiare, Komuna nuk ka shpalosur ndonjë shumë për pronat, objektet dhe pajisjet;
- Ndryshimet për THV në shuma prej 1,508,000 euro në nenin 17 nuk janë shpalosur; dhe
- Nuk janë shpalosur pagesat nga pala e tretë dhe informatat shtesë për të pagueshmet, të arkëtueshmet apo pasuritë tjera të përcaktuara jo në para të gatshme.

## **Konkluzion**

Dobësi në kontrollet e brendshme në lidhje me sistemin e raportimit financiar paraqesin një pasqyrim jo të drejte dhe të saktë të të dhënave financiare.

Pagesat nga pala e tretë për shkak të mos regjistrimit në Free Balance si dhe mundësia e pagesave tjera nga donacionet e huaja nga mos prezantimi i tyre në pasqyrat financiare ka ndikim negativ në pasqyrimin e plotë , të saktë dhe të besueshëm të pasqyrave financiare.

### **Rekomandimi 1**

#### **Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj:**

- Se pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të UA të cilat nxirren në fund të vitit nga ana e MEF dhe janë në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP) “Raportimi Financiar, në Bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme”; dhe
- Se pasqyrat financiare përmbajnë te gjitha informatat relevante dhe këto informata janë të pasqyruara drejtë në pasqyrat financiare.

## **2.2 Pajtueshmëria në lidhje me raportimin e jashtëm**

1. Komuna nuk ka arritur të përgatisë PF plotësisht sipas UA nr. 20/2009 mbi raportimin vjetor të organizatave buxhetore;
2. PF janë nënshkruar me 02 shkurt 2010 nga Zyrtari kryesor administrative dhe zyrtari kryesor financiar .
3. PF-Janë përgatitur në pajtim me SNKSP “Raportimi Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme”
4. PF- Janë dorëzuar në MEF/Thesar më datën 02 shkurt 2010
5. PF janë përgatitur vetëm në Gjuhën Shqipe; dhe
6. Nuk janë dorëzuar raporte financiare tremujore tek Ministri i MEF-it gjatë vitit 2009.

## VII-3 Realizimi i Buxhetit

### 3.1 Menaxhimi i të hyrave

Sipas të dhënave nga Thesari të hyrat vetjake të Komunës për vitin 2009 ishin 4,117 milion ndërsa sipas pasqyrave financiare 4,342 milion.

Prezantimi dhe shpalosja e të hyrave nuk është bërë sipas UA nr. 20/2009 mbi raportimin vjetor. Testimet për të hyrat vetjake të Komunës kanë rezultuar me këto të gjetura të paraqitura në pikat si në vijim:

#### **3.1.1 *Kontrolli jo përkatës lidhur me kalkulimin e kompensimit të tokës ndërtimore për leje ndërtimi***

Në testimin e dy mostrave të cilat kishin të bëjnë me kërkesën për leje ndërtimi, në përlllogaritjen e kompensimit për rregullimin e tokës ndërtimore me kushte të njëjta ishin kalkuluar çmime të ndryshme.

a) Në rastin e parë bazuar në konkluzionin nr.04 / 4-353-850 pjesa e ashtuquajtur "Terasa" kalkulohet me çmim prej 10 €/m<sup>3</sup> dhe shuma e fituar zbritet për 75%, si dhe shuma përfundimtare e llogaritur prapë zbritet për 14.55% për ta fituar vlerën për pagesë.

b) Në rastin e dytë sipas konkluzionit nr. 04/4-353-849 e ashtuquajtura "Terasa" është kalkuluar sipas çmimit në rastin e parë, por me ndryshim që nga vlera e fituar nuk është zbritur shuma prej 75% por vetëm 7.5%.

c) Në tre objekte tjera sipas konkluzionit Nr. 04/4-353-40, 04/4-353-808 dhe 04/4-353-874 janë, përlllogaritur shumat për pagese në letër të thjeshtë duke mos përfshirë këto përlllogaritje në përmbajtjen e konkluzionit. Tek këto objekte m<sup>3</sup> për podrume është llogarit me çmim prej 3€/m<sup>3</sup> dhe zbritje prej 50%.

#### **3.1.2 *Dokumentacioni mbështetës i të hyrave vetjake nuk është në ruajtje***

Standardet Ndërkombëtare të Sektorit Publik kërkojnë që çdo e hyrë vetjake duhet të mbështetet me dokumentacionin burimor dhe të prezantohen në regjistrin detal dhe të ruhen. Ne kemi vërejtur se Komuna e Prizrenit dokumentet mbështetëse për të hyrat nuk i ruan.

Një faturë e kërkuar nuk është ofruar, si dhe kërkesa jonë për ofrimin e një regjistri detaj të të hyrave ishte e pa realizueshme.

### ***3.1.3 Mos harmonizim në mes drejtorisë së financave dhe Thesarit***

Kemi vërejtur se përkundër raportimit mujor të të hyrave ekziston një mos barazim në mes drejtorisë së financave dhe Thesarit. Shuma prej 855,416€ ishte prezantuar nga DUPH ndërsa sipas Thesarit kjo shumë ishte 847,398€. Pra kemi një mos barazim prej 8,018€. Një gjendje e tillë e mos barazimeve ishte edhe në mes drejtorisë së financave të Mjekësisë Familjare dhe të dhënave nga Thesari.

### ***3.1.4 Kontrolli mbi llogarit e arkëtueshme nuk funksionon si duhet***

Përkundër regjistrimit të kontratave në regjistër dhe në kontabilitet ne kemi gjetur se shuma vjetore për dy kontrata që kapin vlerën prej 35,436€ nuk ishin regjistruar në llogarinë përkatëse. Në kontabilitet ishte regjistruar shuma prej 29,504€ ndërsa në regjistrin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike ishte shuma prej 28,332.00€.

### ***3.1.5 Borxhi nuk mbledhet brenda kornizave kohore të përcaktuara***

Ne kemi rishikuar faturat e papaguara për tatimin në pronë të cilat kanë të bëjnë me lokalet në shfrytëzim dhe borxhi në fund vitin 2009 ishte 301,631€ ndërsa borxhi i bartur për vitin 2010 ka shënuar një rritje prej 26%.

Komuna nuk është në gjendje të përgatit raporte të sakta dhe të besueshme lidhur me shkallën e inkasimit apo të përcjell inkasimin e të hyrave në kohën e duhur.

Është praktikë e Komunës të ngarkoj tatimin në pronë në vitin aktual për të gjitha pronat e regjistruara deri në shkurt të atij viti. Për testim kemi marrë 10 mostra nga regjistri i pronës dhe në këtë rast kemi vërejtur se regjistrimi i pronës ishte bërë, por këto prona nuk ishin tatimuar në vitin 2009.

## **Konkluzion**

- Mungesa e analizave adekuate të tarifave, kontrollet jo të duhura dhe të pamjaftueshme në lidhje me të hyrat dhe sistemin e faturimit rrisin rrezikun që të hyrat të keqprezantohen apo edhe të keqpërdoren;
- Komuna nuk ka aplikuar mekanizma të duhur kontrolli mbi gjendjen e të hyrave. Në një situatë të tillë nuk është e mundur të bëhen barazimet mbi të hyrat sipas evidencave kontabël dhe sistemit të faturimit; dhe
- Niveli i ulët i normës së arkëtimit mund të ndikojë mjaft në mundësinë që komuna të kryej aktivitetet aktuale sikurse edhe planin e zhvillimit në të ardhmen.

## **Rekomandimi 2**

### **Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj:**

- Përshtatshmërinë dhe zbatueshmërinë e Rregullores për Tarifa dhe ngarkesat nga Shërbimet dhe Veprimtaritë Komunale dhe të përcaktoj qartë përgjegjësitë;
- Se janë ndërmarr hapat e duhura që të sigurohet zvogëlimi i rrezikut të mundshëm që vjen nga mos mbrojtja e dokumenteve burimore dhe mungesa e regjistrave. Informacion i harmonizuar në mes departamentit të faturimit dhe të kontabilitetit;
- Të kryej barazime të rregullta midis dy sistemeve në periudha të rregullta për të gjitha llojet e të hyrave. Në rastet kur ka diferenca, ato duhet të hulumtohen dhe të zgjidhen brenda afatit të caktuar; dhe
- Organet e komunës duhet të ndërmarrin masa në ngritjen e normës së arkëtimit në një nivel të pranueshëm.

## **3.2 Menaxhimi i Shpenzimeve**

### **3.2.1 Pagat dhe Mëditjet**

Buxheti për kategorinë paga dhe mëditje për vitin 2009 ka qenë 10,284,000 €, derisa pagesat aktuale për paga gjatë vitit 2009 ishin 10,112,000€. Numri i punëtorëve të Komunës në fund të vitit 2009 ishte 3127 .

Shpenzimet për paga të paguara gjatë vitit 2009 sipas sistemit të payroll-it ishin : 9,522,025€ Pagesat për paga të prezantuara në pasqyrat financiare ishin 10,112,310€.

Bazuar në analizat tona të të dhënave të Pasqyrave financiare, ne kemi konstatuar një numër të kufizuar të pagesave të pagave dhe mëditjeve, të kryera në mënyrë të drejtpërdrejtë (jashtë sistemit të listës së pagave).

Komuna kishte paguar, ndonëse me kontratë të rregullt edhe 28 Arsimitar të arsimit përmes kategorisë së ‘‘Mallrave dhe Shërbimeve’’.

Me qëllim të verifikimit se shpenzimet e pagave janë në përputhje me dokumentet mbështetës, ne kemi marrë për testim 10 dosje në zyrën e personelit. Në bazë të testimit të shumave të kontraktuara dhe shumave të paguara është vërejtur një diferencë prej 4,576€ .

## Konkluzion

Kjo mënyrë e trajtimit të pagesave shtesë nuk është transparente. Sipas mendimit tonë, duhet të merret parasysh gjetja e zgjidhjeve tjera teknike për këto lloje të pagesave. Edhe pse gjetjet e lartpërmendura nuk kanë efekt material në pasqyrat financiare, mungesa e komunikimit në kohë dhe aprovimit nga autoritetet përkatëse ose mungesa e dokumentacionit në dosje mund të sjellë mospërputhje me Legjislacionin dhe kërkesat Rregullative.

### Rekomandimi 3

#### Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj se:

- Pagesat për të gjithë të punësuarit e Komunës është bërë sipas kërkesave ligjore dhe dosjet e personelit janë azhurnuar me kohë; dhe
- Të ndërpritet praktika e pagesave të pagave nga mallrat dhe shërbimet. Pagat duhet të procedohen përmes sistemit dhe të paguhen nga kategoria e pagave dhe mëditjeve.

### 3.2.2 Mallrat dhe Shërbimet

Për kategorinë e mallrave dhe shërbimeve nga popullacioni në shumë prej 2,688,220€, ne kemi marrë për testim 10 njësi mostre në një total prej 467,883€. Nga mostrat e testuar kemi vërejtur këto të gjetura :

#### 3.2.2.1 Rrënim i objekteve të ndërtuara pa leje në Prizren

Shërbimet e transportit janë llogaritur me orë pune, ndërsa këto punë sipas specifikacionit teknik janë paraparë me m<sup>3</sup>. Ne nuk kemi gjetur që punët e kryera me Ekskavator janë evidentuar në ndonjë regjistër.

#### 3.2.2.2 Furnizim me lëndë djegëse për shkollat e Prizrenit në vlerë prej 139,190 €

- Zotimi i mjeteve është bërë në vlerë prej 107,000€, ndërsa vlera e kontratës është 139,190 €;
- Në komision për vlerësim të ofertave merr pjesë edhe vetë menaxheri i prokurimit i cili njëkohësisht ka qenë edhe kryesues i komisionit; dhe
- Nuk janë lënë dëshmi se përse operatori ekonomik me çmim më të lirë se fituesi për 8,990 € është eliminuar. Komisioni për vlerësim vetëm ka cekur shpërblimin e kontratës për OE'' pa dhënë komente për të eliminuarit tjerë.

## **Konkluzion**

Mos funksionimi i sistemit të kontrollit të brendshëm në nivelin e duhur ka rezultuar në ekzekutimin e pagesave pa dëshminë e evidencave për orë pune të kryera apo shërbime nga entiteti. Kjo gjithsesi nuk e justifikon daljen e parasë publike.

Në përgjithësi, kontrollet e brendshme vlerësohen të dobëta për t'i ofruar siguri menaxhmentit se proceset e prokurimit dhe pagesave janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret.

### **Rekomandimi 4**

#### **Rekomandojmë kryetarin e komunës që të siguroj se:**

- Paraja publike është duke u shpenzuar në mënyre racionale dhe në asnjë raste nuk do të këtë pagesa pa justifikim për punët e kryera;
- Të përzgjedhë dhe të nënshkruaj kontratat me operatorët ekonomikisht të përgjegjshëm dhe me çmim më të ulët;
- Ekzistojnë mjete të mjaftueshme për realizimin e projekteve dhe në asnjë rast të mos lejohet aprovimi i nënshkrimit të kontratave pa mbulesë të fondeve; dhe
- Forcimin e kontrolleve lidhur me punën e komisioneve të vlerësimit dhe zhvillimit të proceseve të prokurimit në përgjithësi.

### **3.2.3 Avanset për udhëtime zyrtare**

Në vitin 2009 janë paguar 81,460 € në emër të shpenzimeve për udhëtime zyrtare. Në kemi rishikuar gjithsej 9 raste të avanseve dhe në asnjë rast nuk kemi gjetur se aprovimit të kërkesave për udhëtim zyrtar i paraprinte ndonjë agjendë për vendet e vizituara.

## **Konkluzion**

Mungesa e agjendës për udhëtime zyrtare si dhe dëshmi të tjera mbi arsyeshmërinë e udhëtimeve nuk japin siguri se të gjitha udhëtimet zyrtare janë realizuar në funksion të ngritjes apo përfitimeve tjera nga këto udhëtime.



## **Rekomandimi 5**

### **Rekomandojmë kryetarin e komunës që të siguroj se:**

Janë zhvilluar politika dhe procedura të duhura për aprovimin e kërkesave për udhëtime zyrtare si dhe realizimi i udhëtimeve jashtë vendit ka rezultat pozitiv në përfitimin e njohurive dhe marrjen e praktikave më të mira të cilat do të zbatohen nga kuadri i Komunës.

### **3.2.3.0 Investimet Kapitale**

Në vitin 2009 Komuna e Prizrenit ka nënshkruar rreth 290 kontrata me OE të ndryshëm. Shuma totale e kontratave publike të nënshkruara ishte 15,219,681 € ndërsa të paguara në emër të shpenzimeve kapitale ishin 10,652,420 €.

Si pjesë e auditimit tonë, nga kategoria e investimeve kapitale për testim ne kemi marrë 38 mostra përkatësisht kontrata që mbulojnë shumën prej 4,555,416 €.

#### ***3.2.3.1 Projekti për renovim në objektin e Kuvendit Komunal të Prizrenit në vlerë prej 385,214€***

Nuk është kërkuar sigurimi i ekzekutimit si dhe sigurimi i tenderit.

Punimet ende nuk janë kryer dhe nuk janë aplikuar penalet ashtu siç janë paraparë me kushtet e veçanta të kontratës. Pagesa e dytë është bërë me 18/03/2009, datë e cila është dashur të kryhet puna në tërësi. Sipas pohimeve të zyrtarit të prokurimit projekti nuk është realizuar me kohë sepse është bërë ndërrimi i pozicioneve të paramasës.

#### ***3.2.3.2 Ndërtimi i rrugës Enti për punësim Benaf në vlerë prej 986,089€***

Është nënshkruar kontratë në vlerë prej 986,089€, ndërsa mjetet e zotuar për këtë projekt kanë qenë vetëm 200,000€, çka do të thotë se projekti nuk ka pasur mbulesë financiare.

Është eliminuar ofertuesi me çmimin më të lirë në vlerë prej 19,000 € se sa fituesi .Për më tepër, në komision për vlerësimin e ofertave ka marrë pjesë vetë zyrtari i prokurimit i cili ka qenë edhe nënshkruesi i vetëm i kontratave. Sigurimi i tenderit dhe sigurimi i ekzekutimit nuk është kërkuar.

Firma nuk kishte kryer projektin sipas planit dinamik dhe në asnjë rast nuk janë aplikuar penalet për vonesa në realizimin e projekteve.

Vlera e planifikuar për këtë projekt ka qenë në shumë prej 838,000 €.

### ***3.2.3.3 Ndërtimi i objektit të shkollës fillore në fshatin Nashec të Prizrenit faza e II-te në vlerë prej 332,017 €***

Operatori ekonomik në projektin ndërtimi i shkollës fillore në Nashec ka ofertuar në shumë prej 541,658€, ndërsa kontrata është nënshkruar në shumë prej 332,017€. Në dosje të tenderit mungon kërkesa dhe para-llogaria për këtë projekt dhe sipas pohimeve të zyrtarit të prokurimit zvogëlimi i vlerës së tenderit ka ndodhur si rezultat i mungesës së fondeve të zotuara për këtë projekt. Në kontratë është paraparë që shuma e mundshme për këtë projekt do të jetë në vlerë prej 208,000€. Edhe në këtë projekt nuk kemi gjetur se ekziston sigurimi i ekzekutimit ashtu siç kërkon LPP. Në raportin për pranim të mallit dhe shërbimit të mallit ka qenë zyrtari i njëjtë edhe në certifikimin e pagesës.

### ***3.2.3.4 Ndërtimi i shtëpisë së shëndetit në Zhur në vlerë prej 295,141€***

Në kontratë është cekur se punimet mund të zhvillohen deri në shumën prej 100,000 €, ndërsa pjesa tjetër pasi të zotohen mjetet nga urdhri i drejtorit me shkrim për vazhdimin e punimeve. Pra, është nënshkruar kontratë nën vlerën e zotimit. Nuk është kërkuar sigurimi i ekzekutimit nga firma fituese.

### ***3.2.3.5 Punimi i njeje sanitare në vlere prej 121,622€ në fshatin Zhur***

Ky projekt është financuar nga Komuna (57%) dhe donatori i CHF (43%) . Me rishikim të pagesës prej 70,000€, e paguar nga Komuna, nuk kemi gjetur raportin e pranimit të punëve nga organi mbikëqyrës .

Edhe te projekti i ndërtimit të aneksit në shumë prej 149,450€ i cili ka qenë po ashtu bashkëfinancim me donatorin e jashtëm CHF nuk kemi gjetur raportin e pranimit të punëve nga organi mbikëqyrës.

### ***3.2.3.6 Furnizim me automjete për nevojat e Komunës***

Kontrata për furnizim me automjete për nevojat e Komunës ishte nënshkruar me datën 30/10/2008 në vlerë prej 90,000 €. Zotimi i mjeteve për këto automjete ishte 45,000€, çka do të thotë se Komuna nuk ka pasur mjete të mjaftueshme për këto furnizime. Ne nuk kemi rishikuar procedurat e prokurimit të vitit 2008 andaj nuk mund të japim siguri se aktivitetet e prokurimit janë zhvilluar në pajtueshmëri me rregullat e LPP. Nuk kemi gjetur ndonjë procesverbal nga komisioni për pranim të veturave.

### ***3.2.3.7 Ndërtimi i rrugës Kojushë - Garozhup në vlerë prej 1,392,221€***

Nuk kemi gjetur marrëveshjen e komunës dhe MTPT-së për bashkëfinancim në të cilën pjesëmarrja e Komunës ka qenë vetëm 120,000€ ndërsa pjesa tjetër nga MTPT-ja.

Është eliminuar operatori ekonomik i cili ka qenë më i lirë se fituesi për 153,303€. Komisioni për vlerësim në bazë të poentimit e ka shpërblyer OE i cili ka fituar me 88 poenë, për 1 poen më shumë se OE me poenë 87.

### ***3.2.3.8 Ndërtimi i rrugës me elemente betoni i rrugës fshatin Lubizhdë në vlerë prej 120,417€***

Edhe në këtë projekt Komuna nuk ka kërkuar sigurimin e tenderit dhe sigurimin e ekzekutimit. Përkundër vonesave në realizimin e projektit nuk janë aplikuar penale për ditë vonesa.

Në komision për vlerësim ka marr pjesë edhe vetë menaxheri i prokurimit.

Zotimi i mjeteve për këtë projekt ka qenë vetëm 15,000.€ .

### ***3.2.3.9 Ndërtimi i rrugës dhe infrastrukturës”Lagjeje Bajram Curri dhe Ura e Marashit”***

Komisioni për vlerësim ka eliminuar operatorin me çmim më të lirë se fituesi për 50,000€.

Nuk është kërkuar sigurimi i tenderit dhe sigurimi i ekzekutimit ashtu siç kërkon LPP.

Vlera e kontratës ka qenë 1,032,030€, ndërsa zotimi mjeteve për këtë projekt ishte 69,297€.

## **Konkluzion**

Gjetjet e identifikuara më lart janë rezultat i kontrolleve të dobëta nga menaxhmenti i Komunës. Prokurimet e sipër përmendura të Komunës, kanë shkelur Rregulloret e prokurimit. Mangësitë e vërejtura në lidhje me kontrollet e brendshme për sa i takon prokurimeve, janë jashtëzakonisht serioze dhe në mënyrë të theksuar e rrisin rrezikun e prokurimeve të Komunës ndaj mashtrimit, humbjes dhe keqpërdorimit.

## **Rekomandimi 6**

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj se:

- Janë zhvilluar procedura të prokurimit në harmoni me kërkesat dhe rregullat ligjore si dhe të ndërmarr hapa të nevojshëm për performancë më të mirë të aktivitete të prokurimit;
- Me rastin e formimit të komisionit për vlerësim, të caktohen individë të cilët kanë profile të caktuara dhe përmbushin standardet profesionale për vlerësim të ofertave;
- Ekzistojnë fondet e mjaftueshme për realizimin e projekteve dhe në asnjë rast Komuna nuk do të hyjë në obligime pa pasur mbulesë financiare;
- Të gjitha kompanitë që do të fitojnë kontratën, të ofrojë sigurimin e ekzekutimit para nënshkrimit të kontratës;
- Të forcohen kontrollet lidhur me punën e komisioneve të vlerësimit dhe zhvillimit të proceseve të prokurimit në përgjithësi dhe me kontrata të shpërblehen operatorët më konkurrent dhe më të favorshëm;
- Aplikon penalet për mos kryerjen e punimeve në kohën e paraparë nga të gjithë OE sipas kushteve të kontratës;
- Ndërmarrjen e veprimeve konkrete për përfundimin e punimeve të kontraktuara. Të forcohet kontrolli mbi certifikimin e pagesave për parandalimin e veprimeve të tilla. Gjithashtu, të mos lejojë ekzekutimin e asnjë pagesë pa u siguruar se punimet janë përfunduar; dhe
- Që të gjitha vendimet mbi dhënien e kontratës, të jenë të dokumentuara për sa i përket bazës për përzgjedhjen e operatorit ekonomik fitues dhe nëse ofertuesi më i lirë nuk është përzgjedhur, duhet të jepen arsyet e qarta për eliminim.

### **3.4 Subvencionet dhe Transferet**

Vlera totale e shpenzimeve për subvencione dhe transfere në vitin 2009 sipas PF ishte 346,705€. Për testim kemi marrë 10 mostra, në vlerë prej 114,696 €. Shpenzimet nga kjo kategori ishin bërë kryesisht për ndihma për familjet e dëshmorëve, bursave për studentë, Organizatave Jo Qeveritare (OJQ) dhe përkrahje individëve të caktuar.

Subvencionet që i paguhen një njësie të përcaktuar apo një ndërmarrje private duhet të bazohet në një marrëveshje zyrtare ndërmjet organizatës buxhetore dhe pranuesit.

## Të gjeturat

- Ishin planifikuar 100 bursa për studentë në vlerë 50,000€, ndërsa shuma e paguar për këto bursa ishte 56,740€;
- Tek rasti ndihma për OJQ mungonin kriteret dhe kushte për përzgjedhjen e përfituesit. Në kontratë është cekur si fitues një OJQ për organizimin e manifestimit pa pasur ndonjë konkurrencë të mirëfilltë; dhe
- Shuma prej 10,000€ e dhuruar një përfituesi për mbajtjen e manifestimit tradicional “Java e Remzi Ademaj” ishte bërë pa kurrfarë kriteri paraprak.

## Konkluzion

Tejkalimi i pagesave në emër të bursave paraqet planifikim jo efikas të Komunës në njërin anë dhe marrja e vendimeve për pagese të ndonjë organizate pa ndonjë konkurrencë të mirëfilltë mund këtë subjektivizëm dhe transparencë jo të drejtë në anën tjetër. Mos zbatimi i rregullave financiare dhe kriterëve nuk ofron siguri se paraja publike është duke u shpenzuar në mënyrën më të mirë.

### Rekomandimi 7

#### Rekomandojmë kryetarin e komunës që të siguroj se:

- Janë përgatitur plane të mirëfillta dhe të gjitha projektet që subvencionohen kanë një arsyshmëri dhe nuk diskriminojnë konkurrencën eventuale;
- Komuna duhet të formoj komisione profesionale mbi vlerësimin, monitorimin dhe mbikëqyrjen e realizimit të projekteve të financuara nga mjetet e dedikuara për subvencione; dhe
- Komuna duhet të bëjë vlerësimin adekuat të të gjithë aplikuesve të këtyre projekteve dhe mos të shkelen parimet bazë të cilat janë të përcaktuar sipas kriterëve të parapara, por përfituesi i këtyre të jetë ai projekt i cili i plotëson të gjitha kërkesat dhe kriteret e parapara nga Komuna.

## 3.5 Menaxhimi i Prokurimit

Të gjeturat e raportuara në nën-kapitujt e mësipërm demonstrojnë se Komuna e Prizrenit ka ndërmarrë procedurat e prokurimit, të cilat nuk janë në pajtim me Rregulloren 2007/20.

## **Konkluzion**

Komuna e Prizrenit ka çasje jo adekuate mbi proceset e saj të prokurimit, duke e rritur kështu rrezikun e biznesit të keq, humbjeve dhe keqpërdorimeve. Ne kemi gjetur parregullsi të mëdha pothuajse tek çdo prokurim i audituar.

### **Rekomandimi 8**

#### **Rekomandojmë kryetarin e komunës që të siguroj se:**

- Një program specifik është zhvilluar duke siguruar udhërrëfyes mbi prokurimet, duke përfshirë ndarje të qartë të detyrave, të kombinuara me përpjekjet me trajnimet e aplikuarra për zyrtarë për një zbatim sa më të mirë të proceseve të prokurimit; dhe
- Të forcoj kontrollin menaxheria mbi zbatimin e proceseve të prokurimit.

## **VII.4 Menaxhimi i Pasurive**

### **4.1 Pasuritë aktuale**

Paraja e pashpenzuar e të hyrave vetjake në fund vitin 2009 ishte 874,070€.

Sipas analizave të procedurave analitike kemi vërejtur se shumica e mjeteve të pashpenzuara nga të hyrat vetjake ishte 788,640€ dhe donacionet e pashpenzuara 85,430€. Obligimet e papaguara të prezantuara në pasqyrat financiare ishin 2,082,724€.

## **Konkluzion**

Obligimet e mbetura në fund të vitit paraqesin një problem serioz për realizimin e planeve dhe përmbushjen e objektivave për vitin 2010 dhe njëkohësisht çrregullim të projekteve të planifikuara për vitin 2010.

### **Rekomandimi 9**

#### **Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj :**

- Se buxheti i ndarë për çdo vit fiskal do të mbulojë të gjitha obligimet dhe nuk do të ketë inicim të projekteve dhe planifikim para se fondet të jenë disponibile..

## 4.2. Pasuritë Fikse

Nuk është bërë shpalosja e pasurisë fikse në pasqyrat financiare.

Komuna nuk kishte shpalosur informacionet e kërkuara për ndërtesat, pronat dhe pajisjet në pasqyrat financiare. Komuna kishte formuar një komision të vlerësimit të pasurisë i cili ende është në proces të regjistrimit dhe për vlerësimin e pasurive fikse, siç janë: toka, ndërtesat dhe rrugët. Gjithashtu komuna ende nuk ka një regjistër të detajuar dhe gjithëpërfshirës, përfshirë këtu me dokumentacionin mbi pronësinë e patundshmërisë në emrin e Komunës.

### **Konkluzion**

Mungesa e një regjistri gjithëpërfshirës të pronës, objekteve dhe pajisjeve bën të pamundur kontrollin e brendshme mbi pasuritë e Komunës. Kjo mund të shpie deri në keqpërdorim të pasurive dhe në mos identifikimin e këtyre keqpërdorimeve në kohën e duhur.

### **Rekomandimi 10**

**Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se Komuna do të konsiderojë si më poshtë:**

- Të mbajë një regjistër gjithëpërfshirës të pronës, objekteve dhe pajisjeve;
- Të përfshij burime shtesë në regjistrimin dhe vlerësimin e pasurive të Komunës;
- Të bëjë inventarizimin e rregullt fizik për të siguruar ekzistencën e pasurive, dhe kushteve të tyre dhe të barazojë rezultatet e numërimit me të dhënat në kontabilitet dhe regjistër.

## 4.3. Menaxhimi i Detyrimeve

Shuma e paguar në vitin 2009 në vlerë prej 5,108€ kishte rrjedhë si detyrim kontingjent që nga viti 2005. Ky detyrim i paguar në bazë të vendimit të Gjyqit nuk ishte prezantuar dhe shpalosur në pasqyrat financiare të viteve paraprake.

Pra, pasqyrat financiare nuk kanë qenë konsistente prej vitit 2005 deri në vitin 2008.

Sipas shënimeve të paraqitura në Pasqyrat Financiare të vitit 2009, Komuna ka shpalosur se ka detyrime të pa paguar edhe atë sipas kategorive.

Mallra dhe Shërbime	501,381€
Shërbime Komunale	51,980€
Subvencione	20,003€
Investime Kapitale	1,509,360€

Departamenti i shërbimit Financiar dhe i Kontabilitetit i Komunës është përgjegjës për verifikimin e saktësisë së dokumentacionit të pranuar nga Departamentet tjera, regjistrimin, përcjelljen dhe raportimin.

Sipas informatave të lartpërmendura, nuk janë kryer analizat e vjetërsisë së detyrimeve.

Sipas instruksionit Administrativ Nr. 02/2002, Ne një paragraf të këtij instruksioni citohet : Të gjitha faturat e pranuar për mallra dhe shërbime të paguhen në kohë të caktuar.

Data standarde e pagesës është brenda 30 ditëve kalendarike prej pranimit të faturës së dorëzuar në mënyrë të duhur.

### **Konkluzion**

Mungesa e politikave të përshtatshme mbi detyrimet redukton aftësinë e menaxhmentit për kontroll dhe marrjen e vendimeve të drejta dhe efektive sa i përket kësaj- dënimit në raste të vonimeve të pagesave. Për më tepër, detyrimet kontingjente Komunën mund ta sjellin në vështirësi të pa pritura financiare.

### **Rekomandimi 11**

#### **Rekomandojmë kryetarin e komunës që të siguroj se:**

- Kontabiliteti disponon me të gjitha informatat për detyrimet e papaguara dhe veprimet që do të ndërmerren në rast të vonimeve të pagesave.
- Këto detyrime janë të prezantuara drejtë dhe saktë në pasqyrat financiare, ashtu siç kërkon UA 20/2009 apo udhëzimet tjera pasuese gjatë vitit; dhe
- Detyrimet e papaguara duhet të shpalosen, të vlerësohen dhe të buxhetohen për vitin vijues.



## VII.5 Sistemet e Kontrollit të Brendshëm

Ne kemi identifikuar menaxhim dhe kontroll të dobët në fushat në vijim, siç është shfaqur në seksionet më lart.

- Rekomandimet nga viti i kaluar nuk ishin zbatuar në nivelin e pritur;
- Mangësitë menaxheriale të shoqëruara me shumë parregullsi po përsëriten nga viti në vit;
- Përmirësimet në menaxhimin e financave publike janë shumë të ngadalshme;
- Zhvillimi i procedurave të prokurimit duke shkelur rregullat që dalin nga LPP si dhe lidhja e kontratave me operatorët pa sigurimin e fondeve;
- Aplikimi i tarifave me standarde të dyfishta në caktimin e vlerës për leje ndërtimi; dhe
- Sisteme joadekuate për regjistrimin dhe monitorimin e pasurive fikse.

### Konkluzion

Ekzistojnë mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm të Komunës. Një rishikim funksional i sistemit ka nevojë të bëhet. Për pasojë, kontrollet e brendshme të vendosura nga menaxhmenti i Komunës për parandalimin, zbulimin dhe korigjimin e gabimeve, parregullsive dhe mashtrimeve potenciale nuk kanë funksionuar mjaftueshëm.

Në përgjithësi, ne konsiderojmë se niveli i kontrollit financiar është joadekuat dhe duhet të përmirësohet duke i adresuar rekomandimet të nxjerra së bashku me implementimin e atyre të dala nga viti paraprak.

### 5.1. Auditimi i Brendshëm

Në Komunën e Prizrenit ekziston NJAB i cili përbëhet prej një drejtori. Roli kryesor i Njesisë së Auditimit të brendshëm është ofrimi i sigurisë për menaxhmentin që sistemi i kontrollit të brendshëm funksionon siç është synuar.

NJAB nuk kishte përpiluar plan auditimi në vitin 2010. Gjatë vitit 2009 kishte përfunduar katër raporte, prej të cilave dy përfshijnë periudhën e vitit 2009. Raportet të cilat janë kryer nga NJAB kishin si objektive vlerësimin e të hyrave nga tatimi në pronë dhe procedurave të rekrutimit. Në fushëveprimin e tij nuk janë përfshirë sferat me rrezik të lartë për auditim, siç është rasti me sektorin e prokurimit. Ne kemi vërejtur se NJAB nuk ka pavarësi në fushëveprimin e punës. Komiteti i auditivit ishte i themeluar, por ne nuk kemi vërejtur ndonjë kontribut të tij në zhvillimin e auditimit të brendshëm.

## **Konkluzion**

Ne vlerësojmë se përderisa NJAB-it nuk përgatit planet e auditimit në bazë të një analize të hollësishme të vlerësimit të rrezikut dhe nuk fokuson auditimin në fushat me rrezik më të lartë, ne nuk do të mund mbështetemi në rezultatet e auditimit të kësaj njësie për nevojat e auditimit tonë. Për më tepër, as menaxhmenti i komunës nuk mund të pret që auditimi i brendshëm t'i ofroj siguri në funksionimin e kontrolleve.

### **Rekomandimi 12**

#### **Rekomandojmë Kryetarin e komunës që të siguroj :**

- NJAB të planifikoj dhe kryej aktivitetet e saj vjetore duke u bazuar në çasjen ndaj rrezikut për vitin aktual; dhe
- Auditimi i brendshëm duhet dorëzoj raporte të rregullta menaxhmentit duke ofruar këshilla dhe rekomandime në identifikimin e dobësive dhe në implementimin e Sistemeve të Kontrollit të Brendshëm.

## **VII.6 Një konkluzion i përgjithshëm mbi Menaxhmentin e Komunës së Prizrenit**

Konkluzionet e përgjithshme mbi menaxhmentin janë se kontrollet e përgjithshme duhet forcuar. Në krahasim me vitin paraprak, kur janë dhënë 7 rekomandime, gjetjet e këtij viti dhe rekomandimet (12) janë më të larta, flet se kontrollet edhe më tutje kërkojnë përmirësime substanciale. Përmirësimeve duhet kushtuar kujdes i veçantë sidomos tek përpilimi i Pasqyrave financiare, zhvillimi i procedurave të prokurimit, gjetja e mekanizmave për mbledhjen e borxheve nga tatimi në pronë si dhe forcimi i kontrolleve mbi pasuritë.

Dobësitë e identifikuara në kuadër të këtij raporti kemi arritur një konkluzion të përgjithshëm se nevojiten përpjekje të mëtutjeshme, përmirësimin e Menaxhimit Financiar dhe kontrollit brenda komunës së Prizrenit.

Një program revitalizues duhet të organizohet posaçërisht për të adresuar forcimin në:

- Raportimin e jashtëm;
- Raportimin e brendshëm;
- Delegim i qartë dhe transparent dhe ndarje e detyrave;
- Përcjellje menaxheriale; dhe
- Auditim të brendshëm funksional.

## Shtojca 1

### Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit të zbatuara nga ana e ZAP në Raportet Vjetore të Auditimit për vitin 2009

(e shkëputur nga ISSAI 400)

9. Një opinion i auditimit normalisht është në format standard, ndërlidhur me pasqyrat financiare si tërësi, duke shmangur nevojën për caktuar gjatësinë e saj por duke bartur sipas natyrës së saj një

kuptim të përgjithshëm tek lexuesit sipas kuptimit të saj. Natyra e këtyre fjalëve do të ndikohet nga korniza ligjore të auditimit, por përbërja e opinionit duhet të tregoj qartë a është i pakualifikuar apo i kualifikuar, apo nëse është i kualifikuar në disa çështje të caktuara apo është opinion i kundërt (paragrafi 14), apo është mohim i opinionit (paragrafi 15).

10. **Një opinion i pakualifikuar** jepet kur auditori është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale që:

(a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke shfrytëzuar baza dhe politika të pranuar të kontabilitetit të cilat janë zbatuar në mënyrë konsistence (të qëndrueshme);

(b) pasqyrat janë në pajtim me kërkesat statusore dhe rregulloret relevante;

(c) pamja e paraqitur në pasqyrat financiare janë në përputhje me njohuritë e auditorit në lidhje me entitetin e audituar;

(d) është një shpalosje adekuate e të gjitha çështjeve materiale relevante për pasqyrat financiare.

11. **Theksim i çështjes.** Në disa rrethana auditori mundet të konsideroj se lexuesi nuk do të kuptoj në mënyrë të duhur pasqyrat financiare nëse vëmendja është përqendruar në çështje të pazakonshme apo të rëndësishme. Si një rregull e përgjithshme, auditori kur jep një opinion të pakualifikuar kjo nuk i referohet ndonjë aspekti specifik të pasqyrave financiare në opinionin e tij në rast se kjo mund të interpretohet gabimisht si opinion i kualifikuar. Me qëllim të shmangies së kësaj përshtypjeje, referencat që janë menduar si; nënvizim i çështjes; gjinden në paragrafët e ndara nga opinionin. Sidoqoftë, auditori nuk duhet të përdor nënvizimin e çështjes për të përmirësuar mungesën e shpalosjeve të duhura në pasqyrat financiare apo si alternativ, zëvendësim për kualifikim të opinionit.

12. Auditori mund të mos jetë në gjendje të shpreh një opinion jo të kualifikuar kur ekziston një nga ato rrethana dhe në gjykimin e auditorëve, afektin e tyre është ose mund të jetë materiale për pasqyrat financiare:

(a) ka pasur limitime në fushëveprimin e auditimit

Auditori konsideron që pasqyrat janë jo complete apo çorientues apo ekziston një ndarje e pajustificuar nga standardet e pranueshme të kontabilitetit; apo

(b) Ekzistojnë paqartësi që ndikojnë në pasqyrat financiare.

**13. Opinioni i Kualifikuar.** Aty ku auditori nuk pajtohet apo nuk është i sigurt në lidhje me një ose me tepër artikuj të veçantë në pasqyrat financiare e që janë materiale por jo edhe fundamentale në kuptimin e pasqyrave, duhet të jepet një opinion i kualifikuar. Formulimi i opinionit normalisht tregon një rezultat të kënaqshëm ndaj subjektit të audituar, sa i përket një pasqyre të qartë dhe koncize, të çështjeve të mospajtimit apo edhe të paqartësive që ngrisin opinion e kualifikuar. I ndihmon përdoruesit e pasqyrave nëse efekti financiar i paqartësisë apo edhe i mosmarrëveshjeve është përcaktuar nga ana e Auditorit edhe pse kjo nuk është gjithmonë praktike apo relevante.

**14. Opinioni i Kundërt.** Aty ku Auditori nuk ka mundësi të jap një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, për shkak të mosmarrëveshjeve që është aq thelbësore ngase e minon pozitën e prezantuar në vazhdim që opinionin që kualifikohet në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, atëherë jepet opinion i Kundërt. Formulimi i një opinionin të tillë e bën të qartë se pasqyrat financiare nuk janë prezantuar në mënyrë të drejtë, duke specifikuar qartë dhe në mënyrë koncize të gjitha çështjet e mosmarrëveshjeve. Përsëri, është një ndihmesë që efekti financiar mbi pasqyrat financiare përcaktohet aty ku duhet dhe është praktik.

**15. Mohimi i Opinioneve.** Aty ku Auditori nuk mund jep opinion në lidhje me pasqyrat financiare, të marrë si tërësi për shkak të paqartësisë apo restriksione të fushëveprimit që është thelbësor që një opinion që është i kualifikuar në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, jepet opinion i kundërt. Formulimi i një opinionin të tillë të kundërt a bën të qartë që një opinion nuk mund të jepet, duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha çështjet e paqarta.

16. Është bërë zakon që ILA të ofrojnë një raport të detajuar për të plotësuar opinion në rrethana në të cilat është e pamundur të jepet një opinion jo i kualifikuar.

## Shtojca 2

Menaxhmentit të Komunës i është dhënë mundësia për të dhënë komente mbi draftin e këtij raporti . Menaxhmenti ka dhënë një numër komentesh të cilat i kanë qartësuar çështjet e ngritura dhe më pas janë ndryshuar .Çështjet e papërfunduar, për të cilat ne si auditorë dhe entiteti i audituar ende kemi pikëpamje të ndryshme , janë si me poshtë:

### Komentet e Komunës së Prizrenit dhe konkluzionet e ZAP-it

Nr.	Referenca	Komentet e Komunës së Prizrenit	Konkluzionet finale të ZAP-it
1.	2.1 Cilësia e informatave	<p>a) Në rekomandimin nr. 1 se pasqyrat financiare duhet të përgatiten sipas UA 20/2009 sipas nenit 9 pika 3 ku thuhet se pranimet duhet të jenë të barabarta me pagesat, ndërsa në këtë tabelë janë paraqitur të gjitha pranimet deri në fund të vitit, por edhe të gjitha pagesat e planifikuara. Prandaj, për këtë rekomandim do të kemi kujdes dhe ju sigurojmë se do të japim të dhënat sipas UA 20/2009.</p> <p>b) Në rekomandimin e regjistrimit të pasurisë fikse dhe vlerësimin e pasurisë sipas UA 21/2009, ju njoftojmë se është formuar një komision për vlerësimin e pasurisë fikse në vitin 2009, komisioni është duke punuar dhe këto të dhëna nga komisioni do ti paraqesim në pasqyrat financiare vijuese(faqe 10)</p> <p>c) Në faqen 10. thuhet se nuk është shpalosur shuma prej</p>	<p>Menaxhmenti i komunës pajtohet me dobësitë ekzistuese dhe ka filluar të ndërmarr veprime konkrete mbi korrigjimet e nevojshme. Në auditimin e radhës do të përcjellim shkallën e implementimit.</p> <p>Ne kemi konstatuar se komuna nuk ka shpalosur në shënimin 27 të pasqyrave financiare e cila kërkon që të bëhet përmbledhje e pasurisë jo financiare të cilën e ka në posedim komuna.</p> <p>Mos shpalosja dhe mos prezantimi në pasqyrat financiare do të thotë se pasqyrat financiare nuk përmbajnë të gjitha informatat relevante dhe këto informata nuk janë të pasqyruara drejtë në pasqyrat financiare.</p>

		<p>1,508,000 €, sqarimet kanë qenë të qarta , por ju njoftojmë se kjo shumë nënkupton :Të hyrat vetjake të bartura nga viti 2008 në vlerë prej 1,114,000 € dhe rritja e të hyrave vetjake nga ato të planifikuar në vlerë prej 394,000 € që gjithsej bëjnë</p> <p><math>1.114.000+393.000=1,508,000\text{€}</math>,vlerat janë të rrumbullakuara.</p> <p>d) Në faqen 25. Detyrimi kontingjent I paguar në vitin 2009 në vlerë prej 5,108 €, kjo vlerë ka qenë si rezultat I vitit 2005, dhe ky detyrim nuk është paraqitur në fund të vitit në zyrën tonë.</p>	Gjetjet e auditimit mbeten të pa ndryshuara.
2.	<b>3.1.1 Kontrolli jo përkatës lidhur me kalkulimin e kompensimit të tokës ndërtimore për leje ndërtimi</b>	<p>a) Sa I përket testimit të dy mostrave të cilat kishin të bëjnë me kërkesën për leje ndërtimi për llogaritjen e kompensimit për rregullimin e tokës ndërtimore janë kalkuluar çmime të ndryshme për këtë arsyeje :</p> <p>Në rastin e parë në konkluzionin Nr;04/4-353-850,si investitor është ndërtim i vikend shtëpizës në Prevall në ngastrën kadastrale Nr. 144/4 me sipërfaqe të ngastrës S= 270 m është zbritur nga shuma përfundimtare 14,55 % sipas palës së lartpërmendur i është marrë nga posedimi gjegjësisht nga prona 14,55% ky sipas</p>	<p>a)Zyrtarët përgjegjës, po ashtu edhe me dokumentacionin e bashkangjitur komenteve nuk është ofruar një dëshmi si vendimin e Asamblesë Komunale i cili është cekur në Raportin e Drejtorisë dhe Planifikim Hapësinor si dëshmi për verifikim</p> <p>b) Vendimet janë të plotfuqishme dhe zbatohen kur ato aprovohen nga organet kompetente.</p>

		<p>vendimit te Asamblesë Komunale me nr. 01/011-4 te dt. 28 dhjetor 2006. Ndërsa në rastin e dytë sipas konkluzionit me nr. 04/4-353-849 i ndërtim i vikend shtëpizës në Prevall në projektin kadastrave Nr. 150/5 me sipërfaqe të kadastrës Nr. 271 m<sup>2</sup> është zbritur nga shuma përfundimtare 7.5% sepse aq sipërfaqe është marrë nga posedimi gjegjësisht nga prona</p> <p>b) ndërsa sa I përket llogaritjeve prej 50%,75%,25% shërbimi i këtij organi ka bere propozim për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tarifa,ngarkesa dhe gjoba nga shërbimet dhe veprimtarit komunale për pjesën e Drejtorisë se Urbanizmit dhe planifikimi hapësinor përkatësisht, të plotësohet neni 6.3 alenija 1.3 dhe 4 ashtu që të përfshihet sipërfaqja për bodrum 50% nën kulm,75% ballkone dhe tarasa 25% të çmimit për shfrytëzimin e tokës ndërtimore në zonën në të cilën I takon objekti.</p>	Komentet e Komunës nuk e ndryshojnë konkluzionin tone.
3.	<b>3.1.2 Dokumentacioni mbështetës i të hyrave nuk është në ruajtje</b>	Çdo e hyrë vetjake e ka një dokument burimor, e ky dokument burimor është ekstrakti Bankar ku regjistrohen të gjitha të hyrat në bazë të një dokumenti të prezantuar nga palët në Banke. e Banka në bazë të këtij dokumenti regjistron të hyra në ekstrakt në bazë të emrit të palës dhe në bazë të llojit të hyrës – Bar-kodit (Unirefin sipas udhëzimit të MEF-it). Ky dokument për regjistrim - ekstrakti Bankar na prezantohet në baza	Ekipi i auditimit ishte i njoftuar me sistemin që keni komentuar, por çështja është se ka munguar një regjistër i përditësuar dhe detajuar i dokumenteve burimore që krijojnë të hyra, si bazë për të vërtetuar se komuna ka në zotim të ardhurat nga burimet e veta.

		ditore nga sistemi i Free -Balancë-it ku specifikohen të hyrat e të gjitha bankave. Këto dokumente ruhen në arkivin e KK-se 7 (shtatë) vite ashtu si parashihet me Ligjin për Menaxhimin e Financave. Çdo informate për regjistrimin e të hyrave që është kërkuar nga ana e juaj me kohe i'u është prezantuar.	Komentet nuk e ndryshojnë konkluzionin tonë.
4.	<p><b>3.1.3 Mos harmonizimet në mes Drejtorisë së Financave dhe Thesari</b></p> <p><b>Arsyetim lidhur me auditimin e të hyrave në QKMF në Prizren në vitin 2009</b></p>	<p>Harmonizimi në mes Drejtorisë së Financave dhe Thesarit bëhet në baza mujore, ndërsa në baza 3 (tre) mujore hartohet procesi për barazim në mes Thesarit qendror dhe Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, Raport të cilin ua kemi prezantuar dhe prapë ia bashkë ngjisim kësaj përgjigje</p> <p>Mos harmonizimi në mes të disa kodeve të ne dhe në Thesar rezulton nga shkak i mos deshifrimit i llojit të të hyrës me kohë. Këto korrigjime të ne bëhen në KK, ndërsa në Free -Balance nuk kemi qasje për korrigjim. Por, megjithatë totali i përgjithshëm i të hyrave me Thesarin në tërësi përputhet.</p> <p>Arsyeja e mosbarazimit të të hyrave vetjake të QKMF-së në Prizren në vitin 2009 të arkëtuara në llogarinë e Komunës së Prizrenit dhe transferimi prej Komunës në Thesar është ndërprerja para përfundimit të muajit dhe e njëjta diferencë e bartur disa muaj me radhë, mirëpo në fund të vitit kjo diferencë po barazohet çka tregon për lëshimin teknik .Do të kemi kujdes në të ardhmën që kjo</p>	<p>Ne lidhje me barazimet ne kemi konstatuar se nuk ka pasur barazime në mes departamenteve të cilat krijojnë të hyra dhe Drejtorisë së Financave.</p> <p>Prandaj, rekomandimet e dhëna në këtë raport do të jenë të dobishme që zyrtarët e komunës do të marrin parasysh dhe do të implementojnë.</p>



		<p>dukuri të mos paraqitet ngase e gjithë kjo është paraqitur nga arsyet e lartpërmendura jo të qëllimta.</p> <p>Kërkojmë që të na mirëkuptoni dhe sqarimet e dhëna në arsyetimin tonë do pranoni si të arsyeshme. Ju Përshëndesim dhe Falënderojmë.</p>	
5.	<b>3.1.4 Kontrolli mbi llogarite e arkëtueshme nuk funksionon si duhet</b>	<p>Për të dhënë sqarime në lidhje me këtë pikë nuk kemi njohuri se për cilat kontrata bëhet fjalë. Te ne e di që bëhet ngarkesa në bazë të dokumentit bazë të Drejtorisë përkatëse i prezantuar në Drejtorinë për Financa (në rastin konkret është cek Drejtoria e Shërbimeve Publike). Për sqarim nuk është fjala për faturat e tatimit në pronë, por për qiranë e lokaleve</p>	<p>Çështja është diskutuar dhe ka të bëjë me kontratat e lidhura për shfrytëzimin e lokaleve me qira të marra në Drejtorin e Shërbimeve Publike.</p> <p>Komentet nuk e ndryshojnë konkluzionin tonë.</p>
6.	<b>3.1.5 Borxhi nuk mblidhet brenda kornizave kohore të përcaktuara</b>	<p>Borxhi në fund të vitit 2009 për qiranë e lokaleve ishte 301.631.00. Bartja e borxhit në vitin 2010 është 301.630.12. Dallimi në mes obligimeve 2009 të regjistruara në vitin 2010 është 1.30 e jo 26% rritje si ceket në raport. Bashkangjitur ua dërgojmë listën e obligimeve të lokaleve për vitin 2009.</p> <p>Raportet e inkasimit të të hyrave përgatiten në baza ditore dhe janë të sakta sepse ato patjetër duhet të barazohen me ekstraktin Bankar, këtu nuk ka mundësi të mos barazimit në cent e lëre në Euro, kjo çështje iu ka prezantuar gjatë procesit të kontrollit ku shihet edhe raporti I barazimit me Thesarin për çdo periudhë si dhe</p>	<p>Borxhi i mbartur nga viti 2008 në vitin 2009 ishte 238,844,39, ndërsa borxhi i bartur nga viti 2009 në vitin 2010 ishte 301,631,42 €, që tregon tendencë rritje të borxheve për 26%.</p> <p>Menaxhmenti i komunës nuk konteston gjetjet e raportit, por ofron shpjegime se nën cilat rrethana kanë ndodhur.</p> <p>Ne presim zbatimin e rekomandimit lidhur me këtë çështje</p>

		<p>në fund të vitit.</p> <p>Është e vërtete se pronat të cilat regjistrohen deri në shkurt të vitit përkatës, të njëjtat edhe tatimohen .</p> <p>Zyra e përhershme e tatimit në pronë e KK Prizren për vitin 2009 e ka bërë regjistrimin e pronave të reja, mirëpo njëkohësisht të gjitha ato prona nuk janë futur në sistem për tatim.</p> <p>Arsyeja qëndron në faktin se programi nuk ka qenë funksional sepse Departamenti i Tatimit në Pronë në bashkëpunim me SIDA Suedeze kanë krijuar një Softuer (program) të ri të tatimit në pronë dhe prej datës 12.02.2009 deri në fund të muajit maj 2009 për shkak të bartjes së shënimeve nga programi i vjetër në programin e ri nuk kemi pas kurrfarë qasje ne futjen e të dhënave në sistem. Këto të dhëna janë bartur prej muajit Qershor.</p> <p>Neni 9 Paragrafi 1 i Rregullores për Tatimin mbi Pronën e Paluajtshme në Kosovë Nr. 2003/29, thotë se të gjitha pronat që janë regjistruar deri me 1 Mars ose para 1 Marsit i nënshtrohen tatimit.</p> <p>Kështu që për shkak të pengesave të cekura më lartë disa prona të cilat janë futur në sistem prej muajit Qershor nuk janë tatimuar për vitin 2009 për shkak të kalimit të afatit ligjor dhe prona tatimohen për vitin 2010.</p>	
--	--	---	--

		<p>Në mënyrë permanente bëhen përpjekje që çdo e hyrë të kontrollohet dhe të regjistrohet në vendin e duhur, në të ardhmen do ti kemi parasysh edhe rekomandimet e Auditorit.</p> <p>Drejtorja e Financave Ekonomisë dhe Zhvillimit bënë përpjekje të vazhdueshme që inkasimi të bëhet në përputhje të plotë me Rregulloren për Tarifat, Ngarkesat, dhe Gjobat nga Shërbimet dhe Veprimtaritë Komunale dhe çdo herë është arrite dhe tejkaluar niveli i arkëtimit sipas objektivit të caktuar nga KK-ja.</p> <p>Rekomandimet e Auditorit në të ardhmën do t'i kemi parasysh duke vepruar me përpikëri në bazë të ligjeve të aplikueshme dhe udhëzimeve administrative të lëshuara nga MEF-i.</p>	
7.	<b>3.2.1 Pagat dhe Mëditjet</b>	<p>Rritja e pagave në vlerë prej 4.576 € është herë pas aprovimit të kërkesës së Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës me Nr. 504/2009 te datës 21.05. 2009, e cila kërkesë nga ana e Asamblesë Komunale në mbledhjen e mbajtur në korrik të vitit 2009, ka aprovuar këtë rritje dhe së këndejmi kjo diferencë nuk ndikon në zvogëlimin e buxhetit komunal, meqë rritja është aprovuar edhe nga ana e Ministrisë së Financave dhe miratuar nga Ministria e Shërbimeve Publike. Gjithashtu kjo ngritje është aprovuar nga ana e dy ministrive, në bazë të volumit të punëve të zyrtareve. Në lidhje me pagesat e 28 Arsimitareve te realizuara,</p>	<p>Ne kemi rishikuar 10 dosje te personelit dhe objektiv kryesor ishte nëse këto dosje përbejnë te gjitha ndryshimet eventuale të pagave apo të koeficienteve.</p> <p>Krahasimi shpenzimeve të pagave të paguara përmes payrollit dhe kontratave për mostrat e testuar ka rezultuar me një diferencë prej 4,576 €. Në kohën e auditimit ne dosjet nuk kemi konstatuar një harmonizim ne mes te kontratave te nënshkruar te zyrtarëve dhe pagave te paguar përmes sistemit te</p>

		përmes kodit të (nen programit) mallrave dhe shërbimeve janë herë me sugjerimin e marrëveshjes në mes të Ministrisë së Financave dhe Dikasterit të Thesarit, në pamundësi për pagesën nga kodi i pagave përmes Ministrisë së Shërbimeve Publike. Me vendimin e Qeverisë së Kosovës, ky numër i Arsimitarëve është legjitimuar dhe është sistemuar në pagesën e Arsimitarëve sipas listës së pagave.	Payrollit Prandaj, konkluzioni ynë, mbetet i pa ndryshuar.
8.	<b>3.2.2.1 Rrënimi i objekteve të ndërtuara pa leje në Prizren</b>	Drejtoria përkatëse pagesat i ka bërë vetë dhe sektori i prokurimit nuk ka pasur qasje në pagesa. Sektori i prokurimit në të ardhmen do ti respektoje Rekomandimet e Auditorit të Përgjithshëm	Çdo pagese për punë apo shërbime e cila ka rrjedhur nga procedurat e prokurimit duhet të nënshkruaj dhe personi i caktuar nga prokurimi për përgatitjen e urdhër blerjes në bazë të kushteve të kontratës.  Konkluzionet e auditimit mbesin të pa ndryshuara.
9.	<b>3.2.2.2 Furnizim me lëndë djegëse për shkollat e Prizrenit</b>	Në bazë të konkluzionit të Zyrës së Kryetarit të Komunës Nr. 3616 të datës 02. 06. 2009, në lidhje me furnizimin me lëndë djegëse, kur Auditori i Përgjithshëm i ka paraqitur vërejtjet e veta në lidhje me furnizimin me lëndë djegëse fq. 15 Nr. 3.2.2.2 Komisioni i parë ka bërë vlerësimin dhe ka vlerësuar sipas rregullave të prokurimit, ndërsa me sugjerimet e zyrës së prokurimit është ngritur një komision tjetër, i cili ka bërë rivlerësimin e tenderëve të caktuara dhe është dhënë tenderi firmës me çmim më të lartë se ajo që ka vlerësuar komisioni i parë	Ne përsërisim edhe njëherë se praktike në zyrën e prokurimit është mungesa e dëshmive për të OE të eliminuar. Është vërtetuar se nuk kemi dëshmi me shkrim për të gjithë ata të cilët janë eliminuar duke i informuar arsyeje të eliminimit. Ne nuk kemi gjetur se ky komision i dytë ka qenë si komision për rivlerësim. Prandaj, rekomandimi i dhënë në këtë raport mbetet i pa ndryshuar duke shprehur se rekomandimi është i qartë.

10.	<p><b>3.2.3.3 Ndërtimi I objektit të shkollës fillore në fshatin Nashec të Prizrenit faza e II-të</b></p>	<p>Pika a.</p> <p>Sipas nenit 60.1.te LPP te shpallur në Rregulloren Nr. 2007/20 sigurimi i ekzekutimit thuhet: Autoriteti kontraktues do të kërkojë nga operatorët ekonomik të cilëve iu është dhënë kontrata që të depozitojë një siguri të ekzekutimit si parakusht për nënshkrim dhe hyrje në fuqi të kontratës si i tillë nëse (i) kontrata e tillë është kontrate e punës (ii) kontrata e tillë është kontrate e shërbimeve për krijimin e programeve kompjuterike (iii) ekziston rreziku se thyerja saj? kontratës së tillë do të shkaktonte jo dëme substantiate autoritetit kontraktues.</p> <p>Pika b.</p> <p>Arsyet pse nuk kemi kërkuar nga operatorët ekonomik sigurimin e ekzekutimit janë:</p> <p>1.Ne si autoritet kontraktues, operatoreve ekonomik në asnjë rast nuk ju kemi dhënë avans për kontratat e lidhura,</p> <p>2.Operatorët ekonomik pasi ta fillojnë realizimin e projektit, faktikisht vetëm kanë hyrë në sigurimin ekzekutimit pasi autoriteti kontraktues nuk ka dhënë avanse për realizim të kontratës,</p> <p>3. Autoriteti kontraktues i Komunes së Prizrenit kontratat që i ka lidhur me operatorët ekonomik gjere</p>	<p>a)Kërkesa për sigurimin e ekzekutimit nuk kushtëzohet me dhënien e avansit OE., por po e citojmë pjesët nga LPP dhe atë</p> <p>Neni 60. te pika 60.2 të LPP-se theksohet: “autoriteti kontraktues do të kërkojë nga operatori ekonomik të cilit i është dhënë ndonjë kontrate me vlerë të mesme ose të madhe, që të depozitojë një siguri të ekzekutimit si parakusht për nënshkrimin dhe hyrjen në fuqi të kontratës se tillë.....”</p> <p>b ,c ) Komuna, nuk e konteston të gjeturën, por vetëm jep arsyetimin. Gjithashtu konkluzionet në raportin tonë kanë për qëllim të evidentoj mungesat në sistemet e kontrolleve të brendshme dhe rreziqet që këto mungesa sjellin. Ne nxisim kryetarin e Komunës të filloj procesin e përgatitjes së politikave dhe procedurave formale se si do të rrjedhin informacionet brenda departamenteve.</p> <p>Po ashtu po ritheksojmë rekomandimin se duhet te ekzistojnë fondet e mjaftueshme për realizimin e projekteve dhe në asnjë rast Komuna nuk do të hyjë në obligime pa pasur mbulesë financiare, të cilat mund të qojnë në humbje të kontrollit mbi detyrimet , si dhe</p>
-----	---	--	--

	<p>më tani nuk ka pasur problem në realizimin e kontratës.</p> <p>4.Për sqarim të këtij neni 60.1 të LPP ju lutemi të kërkonte nga KRPP në Prishtinë dhe të sqarohet se autoriteti kontraktues i Komunës së Prizrenit nuk ka bërë shkelje të ligjit të prokurimit dhe ka vepruar në konform të LPP</p> <p>Pasi që ne si autoritet kontraktues nuk kemi mundësi që ti stimulojmë operatorët ekonomik me dhënje të avansit atëherë dhe nuk kemi kërkuar sigurimin e ekzekutimit të punimeve.</p> <p><b>Pika c.</b></p> <p>Ne vërejtjen e auditorëve se në asnjë rast nuk është vërejtur se komuna ka arritur të realizojë një projekt sipas planit dinamik të caktuar në kontratë. Neve si sektor i prokurimit në asnjë rast nuk na është kërkuar nga drejtoritë përkatëse të cilët i kanë realizuar projektet, që planet dinamike janë tejkaluar dhe duhet që operatorët ekonomik të kenë penale sipas kushteve të kontratës.</p> <p><b>Pika d.</b></p> <p>Pse kontratat janë lidhur pa i pasur mjetet komplet për realizimin e projektit: ne si autoritet kontraktues me buxhet mjaftë të madh dhe me participim të qytetarëve</p>	<p>dënimet në rast të vonimeve në pagesa.</p> <p>Gjetjet e auditimit mbeten të pa ndryshuar.</p>
--	--	--

		në shumicën e rasteve të projekteve nuk kemi mundur ta bëjmë alokimin komplet të mjeteve dhe kjo ka qenë arsyeja pse janë lidhur kontratat për aq mjete sa janë aiokuar. Nëse autoriteti kontraktues nuk do ti lidhte kontratat pa i alokuar të gjitha mjetet, atëherë shumica e projekteve do të mbeteshim pa u realizuar.	
11.	<b>3.2.3.4 Ndërtimi i shtëpisë së kulturës në Zhur</b>	<b>Përgjigjen e kemi dhëne në piken A dhe B</b>	Mbetet i pa ndryshuar konkluzioni ynë.
12.	<b>3.2.3.5 Punimi njejve sanitare në fshatin Zhur</b>	<p>Ky projekt është realizuar prej CHF me participim te KK te Prizrenit. Dhe sektori i prokurimit nuk ka asnjë dokument në lidhje me këtë projekt.</p> <p>Në lidhje me punimin e njejve sanitare në Shkollën Filllore dhe të Mesme të Ulët "Dëshmoret e Zhurit" në Zhur, që ka qenë mbikëqyrëse CHF -ja e cila ka investuar një pjesë të mjeteve dhe raporti i pranimit ekziston në lëndën Nr. 390/ 09 e paguar me 12. 010. 2009 dhe është raport ne gjuhen angleze, i cili raport nuk është konsultuar nga ana e auditorit ne ditët që kontrolluan dokumentacionet në DKASH. Raportin ia bashkëngjisim përgjigjes.</p>	Ne kemi konstatuar se pjesëmarrja ne këto dy projekte të testuara kanë qenë bashkëfinancim në mes komunës dhe donatorit të jashtëm. Por, në këto dy raste nuk kemi gjetur ndonjë raport të përgatitur nga organi mbikëqyrës për punët e kryera dhe pagesa në bazë të këtij raporti.

13	<b>3.2.3.6 Furnizimi me automjete për nevojat e KK Prizrenit.</b>	Pagesa nuk është bërë nëpërmjet sektorit të prokurimit, dhe nuk kemi njohuri për pranimin e automjeteve	<p>Po ritheksojmë konkluzionet në raportin tonë kanë për qëllim të evidentoj mungesat në sistemet e kontrolleve të brendshme dhe rreziqet që këto mungesa sjellin</p> <p>Është paradoks ky koment se sektori i prokurimit nuk ka njohuri, kur dihet se procedurat e prokurimit janë udhëhequr nga ky sektorë.</p>
14.	<b>3.4 Subvencione dhe Transfere</b>	<p>a) Në lidhje me shpenzimet për bursa është dhënë në bazë të aktvendimit Nr. 01/011-1827, të datës 10. 03. 2009, në bazë të cilit është emëruar komisioni prej 5 (pese) anëtareve dhe është caktuar shuma e bursave në vlerë prej 50,000 € një burse është dhënë për minoritete shtesë përmes vendimit të Drejtorisë së Arsimit në vlerë prej 500 €, ndërsa pjesa tjetër në vlere prej 6.240 € ne sugjerim të kryetarit të komunës dhe me vendim të Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës u janë ndarë fëmijëve bonjake të Krushes së Vogël dhe disa fëmijëve që kanë pas raste skajshmërisht të varfër.</p> <p>b) Shuma prej 10.000 € është dhënë sipas konkluzionit Nr. 01/06-2709, i datës 21.04. 2009, të nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe vendimit të marrë nga Drejtoria e Arsimit firmës "Bogdani" me qëllim të lehtësimit të procedurave të pagesave për para kesh, që është dashur t'u jepet shkollave për organizimin e këtij manifestimi.</p>	<p>Komuna, nuk e konteston të gjeturën, por vetëm jep arsytimin.</p> <p>Konstatimi ynë mbetet i pandryshuar në faktin se ne kemi gjetur se në planin për bursa ka qenë vetëm për 100 bursa për studentë ndërsa janë ndarë më shumë se sa janë planifikuar.</p> <p>Po e ritheksojmë konkluzionin se; Mos zbatimi i rregullave financiare dhe kriterëve nuk ofron siguri se paraja publike është duke u shpenzuar në mënyrën më të mirë.</p>



		<p>Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, si bartëse e këtij manifestimi dhe ka formuar komisionin për mbikëqyrjen e këtij manifestimi dhe vlerësimin e kostos financiare dhe çdo shpenzim është dokumentuar me faktuara përkatëse. Për këtë është njoftuar edhe komisioni i auditimit, të cilat ruhen në DKASH. Sugjerimet tona janë në përputhje me rekomandimet e zyrës së auditimit Nr. 7 fq. 21.</p> <p>Këto shpenzime janë bërë nga subvencionet, dhe është bërë mënyra e pagesës përmes firmës në fjale, që të mos dështojë manifestimi tradicional.</p>	
<b>15.</b>	<b>5.1 Auditimi I Brendshëm</b>	<p>Edhe pse komente më konkrete do të kishin dhënë drejtorit përkatëse ku janë dhënë rekomandimet nga auditori gjeneral, në konsultim me menaxhmentin e lartë është zotuar se do të rritet efikasiteti dhe forma e kontrollit të brendshëm nga drejtorit së bashku me zyrën e auditorit të brendshëm edhe pse kjo zyre ka mungesë të stafit sepse posedon vetëm me një (1) auditor</p> <p>Në lidhje me të gjeturën se NJAB - nuk ka një plan të auditimit të brendshëm për vitin 2010 - në dokumentin e juaj lidhur me auditimin për vitin fiskal 2009 , në pikën 12 keni kërkuar Planin e auditimit për vitin 2009 dhe ajo është dorëzuar nga ana e jonë, lidhur për planin e</p>	<p>Ne nuk kemi cekur se nuk keni plan të Auditimit ,por nuk janë përgatitur plane të auditimit mbi bazën e një analize të hollësishme të vlerësimit të rrezikut dhe nuk jeni fokusuar në auditimin e atyre fushave me rrezik më të lartë,</p> <p>Fokusimi i auditimit në fushat me rrezik më të lartë nga ana e auditorit të brendshëm është rekomandimi që të implementohet, dhe kjo besojmë se do t'i ndihmojë vet menaxhmentit të Komunës se do të rritet efikasiteti dhe forma e kontrollit të brendshëm nga drejtorit</p>

	<p>auditimit për 2010 nuk kam pas informatë që është kërkuar nga ana e zyrtarëve tuaj sepse NJAB e ka të përpiluar një planë të tillë në bazë të cilit ka kryer një auditim ( në menaxhimin e pasurisë komunale ) dhe është në përfundim të auditimit të dytë (të Hyrat Komunale ). Megjithatë shpresoj se ka qenë një keqkuptim apo mos informim në lidhje me kërkesën e juaj.</p>	<p>përkatëse.</p>
--	---	-------------------

Më tutje, Menaxhmenti është zotuar që do ti bëjnë të gjitha përpjekjet për ti adresuar të gjitha rekomandimet e dhëna